

Vendim nr. 251, datë 17.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 17.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (M) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: MYNEVERE SPAHO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1118, datë 03.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 11, 15, 17, 18, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71, 71/a dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 28.01.2022 kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ndaj shtetasit A.S., në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penal “Shkelja e barazisë së shtetasve” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 253 dhe 319/ç të Kodit Penal (*KP*), me pretendimin se në një çështje gjyqësore ku ajo kishte qenë palë kishte dhënë një vendim duke shpërdoruar detyrën dhe shkelur me dashje ligjin dhe praktikën gjyqësore. Mbi këtë bazë është regjistruar kallëzimi penal nr. 18, datë 03.02.2022 (*kallëzimi penal nr. 18/2022*).

2. Me vendimin e datës 09.02.2022, Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 18/2022. Prokurori i posaçëm, në marrjen e këtij vendimi, ndër të tjera, ka arsyetuar se nga pretendimet e paraqitura në kallëzim dhe faktet që kanë rezultuar nga përmbajtja e akteve të administruara dhe nga verifikimet e kryera, nuk përmbajnë elementet e veprave të parashikuara nga nenet 253 dhe 319/ç të KP-së, ose të ndonjë vepre tjetër penale. Lidhur me pretendimet e kallëzueses për gjyqtarin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për sa i përket vendimit që ka marrë në procesin gjyqësor, prokurori ka vlerësuar se sipas nenit 137 të Kushtetutës, gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe për vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij. Po sipas prokurorit, fakti se një nga palët në procesin gjyqësor nuk është dakord me vendimmarrjen e gjykatës dhe se ka hamendësime për veprime korruptive në lidhje me gjyqtarin e çështjes që ka dhënë ose që do të japë vendimin, në kushtet kur mungojnë burime të provave ose indicie të tjera të sakta, të rëndësishme dhe në përputhje me njëra-tjetrën, nuk mundet që të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të filluar ndjekjen penale ndaj gjyqtarit të çështjes dhe në të njëjtën kohë nuk mundet që të shërbejë si standard i të provuarit në procesin penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 97, datë 21.03.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkueses. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka argumentuar se, referuar materialit kallëzues, nuk rezultojnë elementet e figurave të veprave penale të pretenduara nga kërkuesja/kallëzuesja “Shkelja e barazisë së shtetasve” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 253 dhe 319/ç të KP-së. Sipas gjykatës, nuk konstatohet në kallëzim ose në materialin shoqërues ndonjë parregullsi në

përmbushje të detyrës ligjore nga subjekti i posaçëm, të atilla që të ngrenë dyshime mbi ekzistencën e ndonjë vepre penale.

4. Për ankimin e kërkuases, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 71, datë 06.05.2022, me të njëjtën linjë arsyetimi, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 97, datë 21.03.2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke urdhëruar miratimin e vendimit, datë 09.02.2022 të prokurorit të posaçëm për mosfillimin e procedimit. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuësja.

5. Me vendimin nr. 00-2025-1118, datë 03.07.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas kolegjit, pretendimet e kërkuases janë parashtruar edhe përgjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, por gjithashtu edhe në mjetin procedural të ankimit, ku konstatohet se janë marrë në shqyrtim nga ana e gjykatave të faktit. Po sipas atij kolegji, nga gjykata e apelit nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 12.05.2026 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit gjyqësor, sipas objektit. Në vijim, në datën 08.06.2026, ajo ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e tre gjyqtarëve të Kolegjit të Gjykatës, të cilëve u kishte kaluar çështja për shqyrtim paraprak. Me vendimin, datë 29.06.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve e ka rrëzuar këtë kërkesë.

II

Pretendimet e kërkuases

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

7.1. *Së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të:

- 7.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në substancë shkaqet e rekursit. Në vendimin e saj për mospranimin e rekursit ka parashtruar shkurtimisht faktet e çështjes, si dhe ka listuar jo plotësisht pretendimet e parashtruara në rekurs.
- 7.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjyqtari i kallëzuar A.S. në vendimmarrjen e tij ka kryer shkelje flagrante të ligjit duke mos respektuar vendimin e Gjykatës nr. 35, datë 10.10.2007 (*vendimi nr. 35/2007*). Mosrespektimi i vendimit nr. 35/2007 përbën një precedent të rrezikshëm për mbi 500 000 (pesëqind mijë) familje shqiptare që kanë përfituar nga procesi i legalizimit.
- 7.1.3. *Së drejtës së ankimit efektiv*, pasi megjithëse në rekurs janë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit procedural dhe material penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij pa u dhënë përgjigje problemeve ligjore.
- 7.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë argumentuar se përse veprimtaria hetimore e Prokurorisë së Posaçme është e plotë, si dhe nuk kanë verifikuar faktin nëse në vendimmarrjen e gjyqtarit A.S. nuk kishte pasur qëllime keqbesimi ose ndonjë interes vetjak që mund t'i kishte ardhur nga pala tjetër në atë proces.
- 7.2. *Së drejtës së pronës*, pasi gjyqtari A.S., nëpërmjet veprimeve të tij të kundërligjshme, ka synuar ta zhveshë “*de facto*” kërkuesen nga e drejta e pronësisë, shkak për të cilin ajo ka bërë kallëzim penal ndaj funksionarit publik.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit

Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se individ i duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se, edhe pse objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, në thelb, kërkesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor që ka vendosur për rrëzimin e ankimit të saj ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. 18/2022 të bërë prej saj. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, Kolegji vlerëson se ajo e justifikon interesin e saj në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur për mosfillimin e procedimit penal ndaj gjyqtarit që ajo ka kallëzuar penalisht, për shkak të dhënies, sipas saj, të një vendimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin dhe me vendimin nr. 35/2007 të Gjykatës, duke i cenuar të drejtën e pronës

12. Duke qenë se, në thelb, pretendimet e kërkuases kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, të fituar prej saj nëpërmjet procesit të legalizimit lidhur me këto pretendime, Kolegji vlerëson se procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkesja synon në drejtim të së drejtës së pronës. Përveç kësaj, procesi penal i nisur me kallëzimin e procedimit penal ndaj gjyqtarit nuk e kushtëzon kërkuesen në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e së drejtës së

pronës që pretendon se i është shkelur. Për më tepër, në lidhje me këtë të fundit, nga materialet e paraqitura me ankimin kushtetues individual rezulton se vendimmarrja e gjyqtarit A.S. është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor deri në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku ky i fundit ka vendosur prishjen dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çështje e cila rezulton ende në proces.

13. Bazuar në këto konsiderata, si dhe duke pasur parasysh që Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*), Kolegji çmon se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuësës në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të saj. Për rrjedhojë, kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

14. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji vlerëson se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuësës.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.